



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

15.11.2021

Për: Bashkimin e operatorëve “**RESULI ER**” SHPK DHE “**KASTRATI**” SHPK
Adresa: Daullas Lagjja Mbrostar Ferko, rruga "Baltës" banesa nr-53, zone kadastrale nr-3980
numer pasurie nr- 62/24, Fier
Adresa: Lagja 14, Rruga Tirana, Prane Gjykates se Apelit, Shkozet, Durrës.

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, **Marrëveshje Kuadër** me disa operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me objekt: “**Blerje Karburanti, përveç Jet A1**” ndarë në **2 (dy) lote për Spitalin Memorial Fier**”, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: **59,722,880** (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e njëzetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë) **Lekë (pa TVSH)** dhe me nr **REF-04429-09-02-2021**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti 1 "Furnizim me lëndë djegëse Diesel (Gazoil)" - Standardi SSH EN 590:2013 + A1:2017**”, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: **13,550,000** (trembëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH**, me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me numër reference **REF-04440-09-02-2021** dhe me afat kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 12 (dymbëdhjetë) muaj të lidhjes së Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme (*jo*): Buletini i Njoftimeve Publike 07.09.2021, Nr.132.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

- | | |
|---|--|
| 1) BOE “GEGA OIL GROUP” sha & “GEGA CENTER GKG” shpk <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> Vlera: 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) lekë (pa TVSH) | K76911001E + K66801001T <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2) BOE “RESULI-ER” SHA + “KASTRATI” SHPK | L12510413V + J61813529P |

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera, marzh fitimi lekë/litër: **11.8** (*njëmbëdhjetë pikë tetë*) lekë (pa TVSH)

3) “TRIOS” SHA

Emri i plotë i shoqërisë

L12805203J

numri i NIPT-it

Vlera, marzh fitimi lekë/litër: **13.94** (*trembëdhjetë pikë nëntëdhjetë e katër*) lekë (pa TVSH)
(*me numra dhe fjalë*).

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1) BOE “GEGA OIL GROUP” sha
& “GEGA CENTER GKG” shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

K76911001E +

K66801001T

numri i NIPT-it

Vlera: **135** (*njëqind e tridhjetë e pesë*) lekë (pa TVSH)
(*me numra dhe fjalë*).

2) “TRIOS” SHA

Emri i plotë i shoqërisë

L12805203J

numri i NIPT-it

Vlera, marzh fitimi lekë/litër: **13.94** (*trembëdhjetë pikë nëntëdhjetë e katër*) lekë (pa TVSH)
(*me numra dhe fjalë*).

1) Arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik BOE “GEGA OIL GROUP” sha & “GEGA CENTER GKG” shpk;

- Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk permbush kriteret e përgjithshme të pranimit sipas Shtojcës 7 të DST, ku përcaktohet se: “Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. Në kontratën e bashkëpunimit nr. Rep 3243 datë 10.05.2021, e paraqitur në SPE nga BOE, janë përcaktuar përfaqësuesit dhe përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, por nuk janë caktuar elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Ofertuesi nuk plotëson pikën 3, seksioni 2.3, “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur fletë analizë të lëshuar nga ISHTI për lotin që konkurron, e cila duhet të jetë lëshuar Brenda 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave. Fletë analiza e paraqitur në SPE nga ofertuesi për lëndën djegëse Diesel (Gazoil), është e lëshuar në datë 01.09.2021, pra para 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave.
- Ofertuesi nuk ka paraqitur Listën e cmimeve të artikujve sipas Shtojcës nr.2 datë 07.10.2021 “Për modifikimin e dokumenteve të tenderit”, sipas të cilës operatorët do të ofertojnë me fitim në lek për litër.
- Ofertuesi nuk plotëson pikën 7, seksioni 2.3, “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratë në lidhje me Faqen e menaxhimit të karburanteve përse i përket shërbimit për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetet shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit

te fotografive me ane te emailit per cdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj .

2) Arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “TRIOS” SHA:

- Ofertuesi nuk plotëson pikën 2, seksioni 2.3, “Kapaciteti teknik” të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka deklaruar se ka stacion të shitjes së karburanteve me pakicë në Bashkinë Fier, të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë qiraje ose akt pronësie), si edhe nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet e kërkuara në përmbushje të këtij kriteri.
- Ofertuesi nuk plotëson pikën 3, seksioni 2.3, “Kapaciteti teknik” të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur fletë analizë të lëshuar nga ISHTI për lotin që konkurron. Fletë analiza e paraqitur në SPE nga ofertuesi është për lëndën djegëse “Mazut”, dhe jo për lëndën djegëse objekt prokurimi Diesel (Gazoil).
- Ofertuesi nuk plotëson pikën 5, seksioni 2.3, “Kapaciteti teknik” të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Vërtetim teknik të lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK) dhe Policë Sigurimi të lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit që vërteton kapacitetet depozituese mbi 1000 litra lidhur me rezervat e operatorit ekonomik.
- Ofertuesi nuk plotëson pikën 7, seksioni 2.3, “Kapaciteti teknik” të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratat e listuara në këtë pikë në lidhje me lëndën djegëse objekt prokurimi Diesel (Gazoil). Deklarata e paraqitur në SPE nga ofertuesi është për lëndën djegëse Solar, si edhe nuk ka deklaruar se disponon një faqe menaxhimi të karburanteve (Eabpage).

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1) “BOE “RESULI-ER” SHA
+ “KASTRATI” SHPK
Emri i plotë i shoqërisë

L12510413V
+ J61813529P
numri i NIPT-it

Vlera, marzh fitimi lekë/litër: **11.8** (njëmbëdhjetë pikë tetë) lekë (pa TVSH)

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.11.2021

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM